

VENDIM
Nr. 6, datë 4.1.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS DISHNICË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Dishnicë të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 48 (dyzet e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 316 (treqind e gjashtëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dishnicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Dishnicë		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
2-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
12-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
15-18, 311-316	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
19-32	Varrezat publike	Në pronësi
33-43	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe dhe shërbime publike)	Në pronësi
87-89,91-93,95-96,98-100, 102-103,105-106,108-110,112, 114-115,117-119,121-124,126-127, 129, 130, 132-133, 135-137	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
90,94,97,101,104,107,111,113, 116,120,125,128,131,134,138, 141-142,148-149,152,154,159, 160 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
180-183	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-	Në pronësi

	kanalizimeve	
--	--------------	--